

VENDIM
Nr. 358, datë 29.5.2019

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR KËSHILLIN KOMBËTAR SHQIPTAR NË
SERBI, PËR MBËSHTETJEN E FUNKSIONIMIT TË KËTIJ KËSHILLI SI DHE
TË ZYRAVE TË TIJ NË PRESHEVË DHE MEDVEGJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) euro, për mbështetjen e funksionimit të këtij këshilli si dhe të zyrave të tij në Preshevë dhe Medvegjë.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin “Shpenzime diplomatike jashtë shtetit”, në zërin “Shpenzime korrente”, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 30 000 (tridhjetë mijë) eurosh, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe